



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
OPERATORI I SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR  
SPITALI RAJONAL SHKODER

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Shkoder, me \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

MIRATOHET  
TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
SENAD HALLUNAJ

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

Me date 20.05.2024 njesia e prokurimit e perbere nga Redona Haxhijaj, Nermin Agovi dhe Ing. Aron Ara te ngritur me urdher prokurimi nr 24 date 20.05.2024 në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Spitali Rajonal Shkoder** harton proces-verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e prokurimit Hartim i Projekt Preventivit me objekt “Rikonstruksion godine së Maternitetit” (Obsetrike, Gjinekologji, Neonatologji, ORL-OKL dhe Dermatologji) me kod(CPV **Projekte 22114311-5, Shërbim per projektim ndertesash 71221000-3** me fond limit **16,413,812.76** (gjashtëmilion e e katërqind e trembëdhjetëmijë e tetëqind e dymbëdhjete.76) leke pa tvsh “Procedure e Hapur e Thjeshtuar”, pasi fondi limit është nën kufirin e ulët monetar për shërbime. kjo lidhur me fondin e Përlllogaritur dhe specifikimet perkatëse është bere me shkresen me nr 636/3 prot date 12.03.2024 për Hartim i Projekt Preventivit me objekt “Rikonstruksion godine së Maternitetit” (Obsetrike, Gjinekologji, Neonatologji, ORL-OKL dhe Dermatologji) Njesia e prokurimit lidhur me procedurën ka hartuar kriteret me përmbajtje si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

**a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*

2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

**b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojcës 2;**

**Argumentimi:** Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

**c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;**

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”.

**d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; ; vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës është **128,276.26 (njëqind e njezete e tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë.26) leke****

**Argumentimi:** Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

✓ Nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

a2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, **Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore** është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimale deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; (*Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore*). Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara me poshtë, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së të vlerës së fondit të limitit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 41, pika 3 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar nga AK.

**2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga MZHUT) ku të përfshihen kategorite:**

**PROJEKTUES ARKITEKT**

- Kat 2/b3, Objekte spitalore ,terminallet në infraskuturë,vepra arti ne infrastrukture
- Kat 2/c,projektim interiere

**PROJEKTUES KONSTRUKTOR**

- Kat 3/a,objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet boton arme deri ne 5 kate

**PROJEKTUES INSTALATOR**

- Kat 4/a, projektim te instalimeve hidro-termosanitare
- Kat 4/b, projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi,si dhe te impjanteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovushme
- Kat 4/c, projektim te linjave e rrjeteve elektrike per objekte civile e industriale
- Kat 4/f, projektim te sistemeve kunder zjarrit
- Kat 4/h- Projektimi i impjanteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- Kat 4/j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV,sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit për objektet civile e industriale.

**PROJEKTUES VEPRRA HIDRAULIKE**

- Kat 5/b furnizim me uje –kolektor shkarkimi

*Argumentimi:* Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe *vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” (shënim-përcaktoni aktin ligjor ose nënligjor specifik dhe nenin përkatës, që parashikon licencimin e subjekteve, në lidhje me veprimtarinë përkatëse për realizimin e shërbimeve objekt kontrate).*

- Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente duke u bazuar ne kerkesat specifikte te percaktuara ne termat e references.
- Bazuar në objektivat e projektit dhe komponentët kryesorë të tij janë përcaktuar kategoritë e mësipërme të licensës së projektimit të Operatorit Ekonomik të cilat janë të domosdoshme për hartimin e projektit dhe përputhen me natyrën e shërbimit dhe sipas deryres se projektimit.
- *Autoriteti Kontraktor per vendosjen e ketyre licensave eshte bazuar ne Detyren e Projektimit, , i cili do te permbaje:*
- Projektuesi duhet të ketë parasysh dhe të trajtojë:
- Kat 2/b3, Objekte spitalore ,terminallet në infraskuturë,vepra arti ne infrastrukture
- Kat 2/c,projektim interiere
- Kat 3/a,objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet boton arme deri ne 5 kate

- Kat 4/a, projektim te instalimeve hidro-termosanitare
- Kat 4/b, projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi,si dhe te impjanteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovushme
- Kat 4/c, projektim te linjave e rrjeteve elektrike per objekte civile e industriale
- Kat 4/f, projektim te sistemeve kunder zjarrit
- Kat 4/h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).
- Kat 4/j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV,sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit për objektet civile e industriale.
- Kat 5/b furnizim me uje –kolektor shkarkimi

**2.3.3** Operatori ekonomik të ketë në stafin e tij(ne rolin e drejtuesit teknik) të Licensës së shoqërisë:

- Arkitekt 1 (një)
- Inxhinier Ndertimi 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)

Lidhur me kete pike operatori ekonomik ofertues duhet te paraqes

a) Kontraten individuale te punes(te vlefshme)

b)Diplome e inxhinierit.

c)CV

d>Listepagesat e deklaruar ne organet tatimore(formulet E-sig 025 ) ne muajin e fundit nga data e zhvillimit te tenderit, inxhinierat bazuar në vkm nr 514 date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare te profesioneve”.

*Kriteri konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku te specifikohen pikat e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohët vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te paraqese Licencat profesionale te stafit kryesor përgjegjës(drejtues teknik te shoqerise) për zbatimin e kontratës ne kategorite si me poshte shenuar:

**PROJEKTUES ARKITEKT** -Kat 2/b3, Objekte spitalore ,terminalet në infraskuturë,vepra arti ne infrastrukture-Kat 2/c,projektim interiere

**PROJEKTUES KONSTRUKTOR** - Kat 3/a,objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet boton arme deri ne 5 kate

**PROJEKTUES INSTALATOR** -Kat 4/a, projektim te instalimeve hidro-termosanitare

-Kat 4/b, projektim te instalimeve termoteknike-kondicionimi,si dhe te impjanteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovushme

-Kat 4/c, projektim te linjave e rrjeteve elektrike per objekte civile e industriale

-Kat 4/f, projektim te sistemeve kunder zjarrit

-Kat 4/h- Projektimi i impianteve ngritëse e transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse etj.).

-Kat 4/j-Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV,sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit për objektet civile e industriale.

**PROJEKTUES VEPRA HIDRAULIKE**- Kat 5/b furnizim me uje –kolektor shkarkimi.

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”b” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Vendosja e këtij kriteri për stafin është bërë në përputhje me kërkesat e shprehura në termat e referencës

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës

- Arkitekt
- Inxhinier Ndertimi
- Inxhinier Elektrik
- Inxhinier Mekanik

**2.3.5** Operatorët ekonomik me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) duhet të deklarojnë që stafi teknik i kërkuar nuk duhet të jete i angazhuar njëkohsisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në procedurën e prokurimit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohet pika e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë në staf 1 (një) ekspert për mbrojtjen kundër zjarrit shoqëruar me diplome, kontratë pune si dhe me certifikatën për mbrojtjen nga zjarri.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohet pika e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve të siguruar për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit duke përfshirë edhe stafin drejtues duhet të jetë jo më pak se 5 (pese) punonjës.

Për këtë duhet të paraqese:

a. Vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i përcaktuar numri i punonjësve të siguruar për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

b. List- pagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit nga data e zhvillimit të tenderit.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 9 të DST ku të specifikohet pika e mësipërme., ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bere ne perputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit te punimeve sipas grafikut te punimeve, qe eshte perlllogaritur ne per zbatimin me sukses te kesaj kontrate

Eshte kërkuar vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë: për përcaktimin e fuqisë punëtore minimale të kërkuar argumentojme se jemi bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të References. *Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë, tregon besueshmëri për autoritetin. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.*

**2.3.8** Operatori ekonomik ofertues në përllogaritjen e ofertës duhet ti referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jete brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”

### **NJËSIA E PROKURIMIT:**

- **Redona Haxhijaj** - Juriste/Sektor i Planifikim Prokurimeve
- **Nermin Agovi** - P/Sektor i Planifikim Prokurimeve
- **Ing.Aron Ara** - Sp/Sektorit Teknik